



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 2024/12 Prot

Tiranë, më 16.02.2024

V E N D I M

Nr. 4, datë 16.02.2024

Për

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT: “ANALIZË E TREGJEVE ME SHUMICË TË
TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETET E TELEFONISË SË LËVIZSHME
(CELULARE) – DOKUMENT PËRFUNDIMTAR””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
3. Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4. Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5. Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 16.02.2024, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit – “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar ””.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI (Rregullimi i Konkurrencës) të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Ligji nr. 9918/2008);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);

3. Rregullore Nr.9 "Për Analizën e Tregut", miratuar me VKD nr.747, datë 17.07.2009, e ndryshuar;
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: "Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar";
2. Projekt - Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin Nr.16, datë 16.11.2023 miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit: "Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)".
2. Këshillimi publik u krye më datë 16.11.2023 – 16.01.2024, dhe nga palët e interesuara kanë dërguar komente nëpërmjet shkresave palët si më poshtë vijon:
 - Vodafone Albania sh.a me shkresën LEA/001/LR, JL, datë 08.01.2024 (referenca e AKEP Nr.2024/7 prot., datë 12.01.2024);
 - One Albania sh.a me shkresën Nr.108 Prot., datë 15.01.2024 (referenca e AKEP Nr.2024/8 prot., datë 15.01.2024);
 - Neofone shpk me shkresën Nr.380 Prot., datë 12.01.2024 (referenca e AKEP Nr.2024/9 prot., datë 16.01.2024);
 - Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr.41/2 Prot., datë 16.01.2024(referenca e AKEP nr.2024/10 Prot., datë 22.01.2024).
3. Në komentet e dërguara palët e interesuara kanë shprehur qëndrimet dhe opinionet e tyre ku vihet re se në lidhje me çështjet e trajtuara kanë përgjithësisht qëndrime të ndryshme për disa nga përfundimet e AKEP dhe masat e propozuara për rregullimin e tregjeve përkatëse, duke i shoqëruar me sugjerimet përkatëse. Përmbledhje e komenteve të palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP për komentet janë paraqitur në Aneksin 1 të dokumentit përfundimtar të Analizës së Tregut.
4. Dokumenti "Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar":
 - a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 16.11.2023 – 16.01.2024, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për

- b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
- c. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918/2008 dhe Rregulloren për Analizën e tregut 9/2009;
- d. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
- e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikën më të mirë rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut në Shqipëri;
- f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.
5. Dokumenti “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar*” përmban:
- përkufizimin e tregjeve përkatëse të analizuar: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet publike të telefonisë së lëvizshme;
 - analizë e konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin nëse ka operatorë me fuqi të ndjeshme në treg;
 - masat rregulluese të vendosura për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT, përfshirë rregullimin e tarifave për FNT.
6. Dokumenti “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar*” shërben si bazë për marrjen e vendimeve për statusin me FNT në tregjet e analizuar për terminimin e thirrjeve, dhe masat rregulluese për sipërmarrësit e përcaktuar me status me FNT.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin, “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohen në faqen e internetit të AKEP : www.akep.al.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
4. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar

Tomi Frashëri



Anëtar

Edlira Dvorani




Anëtar

Lorenc Bako



Anëtar

Bleron Dokle



Anëtar

Armer Juka



Ety